

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME
"INTRALBAN" SHA**



Ne Tirane, sot me 19 korrik 2001, u hartua ky Akt – Themelimi nga:

- **Z. Kostas Thanos**, i datelindjes 20/01/1953, lindur ne Bukuresht te Rumanise, shtetas grek me pashaporte greke me Nr. M. 455987, me adrese 39-th Trias str., 11257 Athine, Greqi, ne cilesine e njerit prej aksionereve themelues dhe njekohesisht perfaqeues i aksionereve te tjere themelues dhe perkatesiht;
- **Shoqeria anonime me emertimin "INTRACOM KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE – SHOQERI ANONIME"** me titullin dallues **"INTRACOM KONSTRUKSIONE"**, me seli ne Koropi te Attikes me zyrat e saj qe ndodhen ne kilometrin 21 te ruges se Re Peania – Markopullo.
- **Shoqerise anonime me emertimin "INTRACOM Sh.a. INDUSTRIA GREKE E TELEKOMUNIKACIONEVE DHE SISTEMEVE TE INFORMATIKES"** me titullin e dallues **"INTRACOM"**, me seli ne Peania te Atikes.
- **Shoqeria anonime me emetimin "INTRAMET KONSTRUKSIONE METALIKE DHE ELEKTROMEKANIKE Sh.a."** me titull dallues **"INTRAMET"** me seli ne Januli te Larises.

Z. Kostas Thanos vepron si perfaqesues i aksionereve te tjere themelues ne baze te prokurave noteriale perkatesisht me Nr.9051 date 05.07.2001; Nr.9049 date 05.07.2001 dhe Nr.9050 date 05.07.2001.

Z. Kostas Thanos dhe shoqerite qe ai perfaqeson themelojne ne Tirane, Shqiperi, **shoqerine anonime "INTRALBAN KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE"** me shkurtimin **"INTRALBAN" sh.a.** Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

1. Shoqeria e ka seline e saj ne **Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", pallati "Sky Tower", kati i 3^{te}, Tirane, Shqiperi** dhe mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithë territorine Republikes se Shqiperise ashtu dhe jashte saj.
2. Shoqeria eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri Anonime pa Oferte Publike.

Objekti i shoqerise eshte:

- a) Studimi, projektimi, zbatimi dhe venia ne funksionim, brenda dhe jashte vendit, te veprave teknike te çdo natyre qofshin, publike, te personave juridike publike dhe private, organizmave dhe privateve, dhe veçanerisht te Veprave Teknike qe u perkasin Veprave te paperfunduara ose te kompletuara si dhe dhenia e sherbimeve te konsulences teknike, ne tema te pergatitjes te cdo lloj studimesh teknike, ekonomike dhe teknikoekonomike te çfaredoltoj kombinimi si me poshte:

1. Rrjete te telekomunikacionit, rrjete transmetimi si dhe rrjete te telefonise se levizeshme te formes celulare ose te çdo forme tjeter.
2. Sisteme dhe rrjete Informatike.
3. Vepra Industriale dhe Energjitike te çdo natyre.
4. Konstruksione metalike te çdo natyre.
5. Pajisje Elektrike
6. Pajisje Elektronike.
7. Pajisje Mekanike.
8. Vepra te gazit natyror
9. Pajisje ndertesash, vepra dheu dhe vepra te tjera ne kompetence te Inxhinierit te Ndertimit



- b) Supervizimi i zbatimit te veprave te permendura ne paragrafin (a) brenda dhe jashte vendit.
- c) Importimi ose/dhe eksportimi ose/dhe tregtimi ose/dhe industrializimi ose/dhe transportimi i mjeteve teknike te çdo natyre, te pajisjeve, te materialeve si dhe materialeve te konsumit dhe te pjeseve te kembimit qe kane lidhje me veprat qe u permenden me lart ne paragrafin (a) brenda dhe jashte vendit.
- d) Te gjitha punimet perkatese te mesiperme te instalimit, te mirembajtjes, te mbeshtetjes etj, si dhe sherbime te tjera.
- e) Pjesemarrja ne tendera te çdo natyre, publike, te personave juridike publike dhe private dhe Organizmave, me qellim marrjen persiper te veprave te mesiperme ose si ndermjetes ose si sipermarres.
- f) Pergatitja e studimeve dhe prodhimi i materialeve dhe programeve per sisteme te reja telekomunikacioni, per zbatime te reja dhe sherbime ne degët e telekomunikacionit dhe informatikes.
- g) Grumbullimi, perpunimi, regjistrimi dhe ruajtja e fakteve dhe informacionieve te çdo natyre, (p.sh ekonomike, shkencore, teknike, shpirtërore etj), dhe venia e tyre ne dispozicion te te treteve me qellim fitimin.
- h) Dhe veprimtari te tjera te mundshme qe parashikohen nga legjislacioni shqiptar.

Per realizimin e objektit te saj shoqeria mundet:

- a. Te marre pjese ne çdo lloj ndermarrje brenda dhe jashte vendit te te njejtit qellim ose te perafert, te cdo lloj tipi orakerie, te shkrihet me nje shoqeri tjeter ose te thith nje tjeter ndermarrje apo shoqeri perkatese, individuale ose jo, te çdo lloj tipi ortakerie, ose te krijoje dege ne nje shoqeri te re, ekzistuese ose ne formim e siper.
- b. Te bashkepunoje me çdo person fizik ose juridik brenda dhe jashte vendit, me çdo lloj menyre per arritjen e qellimit te ortakerise.
- c. Te marre pjese ose te bashkepunoje me kapitalet e veta me ndermarrje ose shoqeri te tjera te çfardo lloj forme juridike qe ekzistojne ose qe do te krijohen brenda ose jashte vendit, qe kane po ato qellime apo te peraferta.
- d. Te shkrihet (me bashkim ose perthithje) me çfaredo lloj shoqerie tjeter (te personave ose kapitaleve) me objekt te njejte ose te perafert te veprimtarise, pavaresisht nga forma juridike e tyre, ose te krijoje shoqeri bija, filiale, nendegje, pika punesimi ose nennjesi te tjera, ose te krijoje shoqeri te re.

2

- e. Te jap garanci (dorezani apo garanci te tjera) te plota ndaj personave te trete fizike ose juridike me te cilet bashkepunon ose tek te cilet merr pjese per arsye fitimi te shoqerise dhe per arritjen e qellimit te ortakerise duke pasur siguri te cdo natyre.
- f. Te kerkoje botimin e letrave te garancise apo te letrave te kreditit ne Leke apo monedhe te huaj ndaj personave te trete fizike apo juridike me te cilet bashkepunon apo tek te cilet merr pjese ne dobi te shoqerise dhe arritjen e qellimit te ortakerise, duke pasur garanci te cdo lloj natyre.

Shoqeria mundet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Shoqeria ka per detyre qe pas themelimit, prezantimit dhe regjistrimit ne regjistrin tregtar te perfitoje te gjitha njohurite e nevojshme si dhe lejet, autorizimet, licensat dhe miratimet e nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj per te cilat kerkohen keto dokumenta administrative.

Objekti i shoqerise mund te ndryshoje ne kuptimin e zgjerimit apo ngushtimit te atij ekzistues, me vendim te asamblese se aksionereve duke ruajtur ne momentin konkret pershtatjen me dispozitat ligjore ne fuqi.

3. Kohezgjatja e shoqerise do te jete **50 vjet**.

4. Kapitali i shoqerise eshte **30.000.000 (tridhjetemiljon) leke** dhe eshte i ndare ne **10.000 (dhjetemije) aksione** me vlere nominale **3.000 (tremije) leke** secili. Kapitali i shoqerise do te derdhet brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga nenshkrimi i aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise.

- Shoqeria anonime me emertimin "INTRACOM KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE – SHOQERI ANONIME" me titullin dallues "INTRACOM KONSTRUKSIONE", me seli ne Koropi te Atikes me zyrat e saj qe ndodhen ne kilometrin 21 te rruges se Re Peania – Markopullo zoteron **4.000 (katermije) aksione** me vlere te **pergjithshme 12.000.000 (dymbedhjetemiljon) leke** qe perbejne **40 (dyzet) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqerise.
- Shoqerise anonime me emertimin "INTRACOM Sh.a. INDUSTRIA GREKE E TELEKOMUNIKACIONEVE DHE SISTEMEVE TE INFORMATIKES" me titullin e dallues "INTRACOM", me seli ne Peania te Atikes zoteron **4.000 (katermije) aksione** me vlere te **pergjithshme 12.000.000 (dymbedhjetemiljon) leke** qe perbejne **40 (dyzet) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqerise.
- Shoqeria anonime me emertimin "INTRAMET KONSTRUKSIONE METALIKE DHE ELEKTROMEKANIKE Sh.a." me titull dallues "INTRAMET" me seli ne Januli te Larises zoteron **1.500 (njemije e peseqind) aksione** me vlere te **pergjithshme 4.500.000 (katermiljon e peseqindmije) leke** qe perbejne **15 (pesembedhjete) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqerise.
- Z. Kostas Thanos, i datelindjes 20/01/ 1953, lindur ne Bukuresht te Rumanise, shtetas grek me pashaporte greke me Nr. M. 455987, me adrese 39-th Trias str., 11257 Athine Greqi zoteron **500 (peseqind)**

aksione me vlere te pergjithshme **1.500.000 (njemiljon e peseqindmije) leke** qe perbejne **5 (pese) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqerise.

- Aksionet jane nominale dhe lirisht te transferueshme sipas ligjit shqiptar ne fuqi.
- Aksionaret pergjigjen per humbjet e shoqerise ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e shoqerise.
Çdo aksion i jep te drejten e nje vote mbajtesit te tij.
- Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet, ne menyren dhe formen e parashikuar me ligj.
- 6. Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor 2001.
- 7. Anetare te pare te Keshillit Mbikqyres te shoqerise jane
 1. Z. Kostandinos Tsoukalidis.
 2. Z. Dimitrios Giannikakis.
 3. Z. Vasil Qiriazati.
- 8. Ekspertet e pare kontabel te autorizuar do te jene;
 1. Z. Kole Gjoni
 2. Z. Elton Haxhi
- 9. Ky Akt i Themelimit te Shoqerise Anonime perpilohet ne 8 (tete) kopje ne gjuhen shqipe.

AKSIONERET THEMELUES

Shoqeria Anonime "INTRACOM KONSTRUKSIONE" sh.a.

E cila perfaqesohet me Prokure nga z.Kostas Thanos

Kostas Thanos 


Shoqerise Anonime "INTRACOM" sh.a.

E cila perfaqesohet me prokure nga z.Kostas Thanos


Kostas Thanos 

Shoqeria anonime "INTRAMET" sh.a.

E cila perfaqesohen me prokure nga z.Kostas Thanos

Kostas Thanos 

KOSTAS THANOS

Kostas Thanos 

**STATUT
I SHOQERISE ANONIME
"INTRALBAN KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE SH.A."
("INTRALBAN" SH.A.)**



Sot, me date 23/07//2001, formohet ne Tirane, Shqiperi, shoqeria anonime "INTRALBAN KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE" SH.A. ("INTRALBAN" SH.A.).

**Neni 1
Emertimi**

Shoqeria emertohet "INTRALBAN KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE" SH.A. Shkurtimi i emertimit te shoqerise eshte "INTRALBAN" SH.A. Emertimi i shoqerise mund te shkruhet me shkronja te medha ose te vogla.

**Neni 2
Selia**

Selia e shoqerise eshte ne **Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", pallati "Sky Tower", kati i 3^{te}, Tirane**. Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

Neni 3

Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi, mund te hape, si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj, qendra dhe perfaqesi apo filiale, degë dhe shoqeri te tjera.

**Neni 4
Kohezgjatja**

Kohezgjatja e kompanise eshte 50 vjet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregtar. Ky afat mund te shkurtohet apo zgjatet para mbarimit te tij, nje ose me shume here, me vendim te asamblese se aksionereve.

**Neni 5
Objekti**

Objekti i shoqerise eshte:

- a) Studimi, projektimi, zbatimi dhe venia ne funksionim, brenda dhe jashte vendit, te veprave teknike te çdo natyre qofshin, publike, te personave juridike publike dhe private, organizmave dhe privateve, dhe veçanerisht te Veprave Teknike qe u perkasin Veprave te paperfunduara ose te kompletuara si dhe dhënia e shërbimeve te konsulences teknike, ne tema

te pergatitjes te cdo lloj studimesh teknike, ekonomike dhe teknikoekonomike te cfareldolloj kombinimi si me poshte:

1. Rrjete te telekomunikacionit, rrjete transmetimi si dhe rrjete te telefonise se levizeshme te formes celulare ose te cdo forme tjeter.
2. Sisteme dhe rrjete Informatike.
3. Vepra Industriale dhe Energjitike te cdo natyre.
4. Konstruksione metalike te cdo natyre.
5. Pajisje Elektrike
6. Pajisje Elektronike.
7. Pajisje Mekanike.
8. Vepra te gazit natyror
9. Pajisje ndertesash, vepra dheu dhe vepra te tjera ne kompetence te Inxhinierit te Ndertimit



- b) Supervizimi i zbatimit te veprave te permendura ne paragrafin (a) brenda dhe jashte vendit.
- c) Importimi ose/dhe eksportimi ose/dhe tregtimi ose/dhe industrializimi ose/dhe transportimi i mjeteve teknike te cdo natyre, te pajisjeve, te materialeve si dhe materialeve te konsumit dhe te pjeseve te kembimit qe kane lidhje me veprat qe u permenden me lart ne paragrafin (a) brenda dhe jashte vendit.
- d) Te gjitha punimet perkatese te mesiperme te instalimit, te mirembajtjes, te mbeshtetjes etj, si dhe sherbime te tjera.
- e) Pjesemarrja ne tendera te cdo natyre, publike, te personave juridike publike dhe private dhe Organizmave, me qellim marrjen persiper te veprave te mesiperme ose si ndermjetes ose si sipermarrjes.
- f) Pergatitja e studimeve dhe prodhimi i materialeve dhe programeve per sisteme te reja telekomunikacioni, per zbatim te reja dhe sherbime ne deget e telekomunikacionit dhe informatikes.
- g) Grumbullimi, perpunimi, regjistrimi dhe ruajtja e fakteve dhe informacionieve te cdo natyre, (p.sh ekonomike, shkencore, teknike, shpirtore etj), dhe venia e tyre ne dispozicion te te treteve me qellim fitimin.
- h) Dhe veprimtari te tjera te mundshme qe parashikohen nga legjislacioni shqiptar.

Per realizimin e objektit te saj shoqeria mundet:

- a. Te marre pjese ne cdo lloj ndermarrje brenda dhe jashte vendit te te njejtit qellim ose te perafert, te cdo lloj tipi orakerie, te shkrihet me nje shoqeri tjeter ose te thith nje tjeter ndermarrje apo shoqeri perkatese, individuale ose jo, te cdo lloj tipi ortakerie, ose te krijoje dege ne nje shoqeri te re, ekzistuese ose ne formim e siper.
- b. Te bashkepunoje me cdo person fizik ose juridik brenda dhe jashte vendit, me cdo lloj menyre per arritjen e qellimit te ortakerise.
- c. Te marre pjese ose te bashkepunoje me kapitalet e veta me ndermarrje ose shoqeri te tjera te cfardo lloj forme juridike qe ekzistojne ose qe do te krijohen brenda ose jashte vendit, qe kane po ato qellime apo te peraferta.

- d. Te shkrihet (me bashkim ose perthithje) me çfaredo lloj shoqërie tjetër (te personave ose kapitaleve) me objekt te njejte ose te perafert te veprimtarise, pavaresisht nga forma juridike e tyre, ose te krijoje shoqëri bija, filiale, nendegje, pika punesimi ose nennjesi te tjera, ose te krijoje shoqëri te re.
- e. Te jap garanci (dorezani apo garanci te tjera) te plota ndaj personave te trete fizike ose juridike me te cilet bashkepunon ose tek te cilet merr pjese per arsye fitimi te shoqërise dhe per arritjen e qellimit te ortakerise duke pasur siguri te cdo natyre.
- f. Te kerkoje botimin e letrave te garancise apo te letrave te kreditit ne Leke apo monedhe te huaj ndaj personave te trete fizike apo juridike me te cilet bashkepunon apo tek te cilet merr pjese ne dobi te shoqërise dhe arritjen e qellimit te ortakerise, duke pasur garanci te cdo lloj natyre.

Shoqëria mundet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi

Shoqëria mund te kryeje cdo veprim me qellim marrjen e lejeve , autorizimeve, licensave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj per te cilat kerkohen keto dokumenta administrative.

Objekti i shoqërise mund te ndryshoje ne kuptimin e zgjerimit apo ngushtimit te atij ekzistues, me vendim te asamblese se aksionereve duke ruajtur ne momentin konkret pershtatjen me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 6 Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërise eshte **30.000.000 (tridhjetemiljon) leke** dhe eshte i ndare ne **10.000 (dhjetemije) aksione** me vlere nominale **3.000 (tremije) leke** secili. Kapitali i shoqërise eshte derdhur dhe nenshkuar teresisht nga aksioneret dhe perkatesisht;

- Shoqëria anonime me emertimin "INTRACOM KONSTRUKSIONE TE VEPRAVE TEKNIKE – SHOQËRI ANONIME" me titullin dallues "INTRACOM KONSTRUKSIONE", me seli ne Koropi te Atikes me zyrat e saj qe ndodhen ne kilometrin 21 te ruges se Re Peania – Markopullo zoteron **4.000 (katemije) aksione** me vlere te **pergjithshme 12.000.000 (dymbedhjetemiljon) leke** qe perbejne **40 (dyzet) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqërise.
- Shoqërise anonime me emertimin "INTRACOM Sh.a. INDUSTRIA GREKE E TELEKOMUNIKACIONEVE DHE SISTEMEVE TE INFORMATIKES" me titullin e dallues "INTRACOM", me seli ne Peania te Atikes zoteron **4.000 (katemije) aksione** me vlere te **pergjithshme 12.000.000 (dymbedhjetemiljon) leke** qe perbejne **40 (dyzet) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqërise.

- Shoqeria anonime me emetimin "INTRAMET KONSTRUKSIONE METALIKE DHE ELEKTROMEKANIKE Sh.a." me titull dallues "INTRAMET" me seli ne Januli te Larises zoteron **1.500 (njemije e peseqind)** aksione me vlere te pergjithshme **4.500.000 (katemiljon e peseqindmije) leke** qe perbejne **15 (pesembedhjete) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqerise.
- Z. Kostas Thanos, i datelindjes 20/01/ 1953, lindur ne Bukuresht te Rumanise, shtetas grek me pashaporte greke me Nr. M. 455987, me adrese 39-th Trias str., 11257 Athine Greqi zoteron **500 (peseqind)** aksione me vlere te pergjithshme **1.500.000 (njemiljon e peseqindmije) leke** qe perbejne **5 (pese) %** te numrit te pergjithshem te aksione te shoqerise.

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet, ne menyren dhe formen e parashikuar me ligj.

Neni 7

Aksionet

1. Aksionet jane te formes emerore dhe lirisht te transferueshme sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
2. Pronesia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre ne emer te titullarit apo titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e shoqerise apo ndermjetesave financiare.

Neni 8

Te drejtat e aksionereve

1. Sejcili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje nxjerrje (ekstrat) nga libri i aksionereve i cili vertetohet me vulen e shoqerise.
2. Sejcili aksioner ka te drejte te verifikoje nese eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar ti tregoje aksionerit , me kerkesen e ketij te fundit, hyrjen perkatese ne liber.
3. Aksionaret pergjigjen per humbjete e shoqerise ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.
4. Aksionet jane te pandashme dhe cdo aksioner i jep te drejten e nje vote mbajtesit te tij. Ne rast se nje aksioner i perket dy a me shume personave, te drejtat qe rrjedhin nga pronesia mbi aksionin mund te ushtrohen nga nje person apo nje perfaqesues.
5. Aksioneret kane te drejten e perparesise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte perpjestimore me shumen e aksioneve te zoteruara nga sejcili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

6. Aksioneret mund te heqin dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja. Ata munden gjithashtu te kerkojne nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas parimit te perpjestueshmerise.
7. Asambleja e Aksionereve percakton nje afat brenda te cilit mund te ushtrohet e drejta e perparisise se aksionereve per nenshkrimin e aksioneve sipas ketij neni. Te drejten per te percaktuar afatin per ushtimin e te drejtes se perparisise per nenshkrimin e aksioneve sipas percaktimeve te mesiperme, Asambleja e Aksionereve mund tia delegoje edhe Keshillit Mbikqyres. Ne cdo rast ky afat nuk mund te jete me i vogel se nje muaj.
8. Pas mbarimit te afatit te percaktuar nga Asambleja e Aksionereve apo Keshilli Mbikqyres per ushtimin e te drejtes se perparisise, aksionet te cilat nuk jane nenshkruar do te disponohen lirisht tek aksioneret qe ushtroan te drejten e perparisise ne perpjestim me shumen e aksioneve te zoteruara nga sejcili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

Neni 9

Shlyerja e aksioneve qe rrjedhin nga zmadhimi i kapitalit

1. Aksionet per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhet te pakten per 50 (pesedhjete) % te vleres se tyre qe ne momentin e nenshkrimit.
2. Pjesa tjeter e vleres do te shlyhet me nje ose disa keste ne baze te kerkimit per shlyerje nga Drejtori i Pergjithshem ne nje afat prej jo me shume se 3 (tre) vjetesh nga dita kur zmadhimi i kapitalit eshte bere perfundimtar.
3. Asambleja e Jashtezakonshme qe vendos per zmadhimin e kapitalit ka te drejte te marre nje vendim per shlyerjen teresore te aksioneveqe ne momentin e nenshkrimit ose brenda nje afati me te shkurter nga ai i permendur ne paragrafin me siper.
4. Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkruesve te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje , me leter rekomande dhe me kthim pergjigje, drejtuar cdo titullari te aksioneve.
5. Cdo vonese ne derdhjen e shumave te kerkuara sjell pagimin e interesave sipas perqindjeve ligjore duke filluar nga data ne te cilen duhet te ishte bere derdhja pa qene nevoja per te proceduar me formalitete te tjera te cfaredolloji dhe pa hequr dore nga veprimet e shoqerise ndaj aksionerit detyrues dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga ligji.



Neni 10

Te drejtat e minorances se aksionereve

1. Duke filluar nga momenti i lajmerimit per mbledhjen vjetore te asamblese se zakoneshme dhe te pakten 15 dite perpara fillimit te saj, çdo aksioner apo mandat mbajtes i emeruar prej tij si perfaqesues ne asamble,ka te drejte qe ne seline e shoqerise te njihet me:
 - Inventarin, bilancin financiar vjetor dhe listen e antareve te Keshillit Mbikqyres dhe Drejtorin e Pergjithshem;
 - Raportet e Drejtorit te Pergjithshem, te Keshillit Mbikqyres dhe te Eksperteve Kontabel te Autorizuar, qe do ti paraqiten asamblese per shqyrtim;
 - Po te jete nevoja, me tekstin dhe argumentet e rezolutave te propozuara, si dhe te dhenat mbi kandidatet per ne Keshillin Mbikqyres.;
 - Shumen e pergjitheshme, te vertetuar me saktesi nga Ekspertet Kontabel te Autorizuar mbi shperblimet e dhena per personat qe paguhen me mire, numri i te cilave duhet te jete 10, ne rast se efektiv i personelit eshte mbi 200 te punesuar dhe 5 ne rastet e tjera.
 - E drejta per informim perfshin edhe ate te dhenies se kopjeve te ketyre dokumentave, perveç kopjes se inventarit.
2. Çdo aksionar, 15 dite perpara mbledhjes se asamblese, ka te drejte te vihet ne dijeni ose te marre kopjet e listes se aksionareve se seline e shoqerise.
3. Çdo aksionar ka te drejte ne çdo kohe ti vihen ne dispozicion dokumentet e shoqerise te permendura me siper per 3 vjetet e fundit financiar, si dhe proces verbalet dhe evidencat e pjesemarrjes se mbledhjeve te asamblese te zhvilluara ne keto 3 vitet e fundit.
4. Ne rast se shoqeria refuzon krejtesisht apo pjeserisht venien ne dispozicion te dokumenteve, ne kundërshtim me rregullat e mesiperme, çeshtja i nenshtrohet vendimit te gjyqit me kerkesen e aksionarit, te cilit i eshte refuzuar kjo gje.
5. Ne rast se shkelen klauzolat e pikes 1(nje) te ketij neni, ceshtjet e shqyrtuara jane te pavlefshme, ndersa nese shkelen klauzolat e pikave 2 (dy) dhe 3 (tre) te ketij neni mbledhja e asamblese mund te anulohet.

Neni 11

Asambleja e Aksionereve

Asambleja e aksionereve, e zakonshme dhe e jashtezakonshme, ne rast se Keshilli Mbikqyres nuk percakton ndryshe, mbledhet ne seline e Shoqerise. Ajo thirret nga Keshilli Mbikqyres apo Drejtori i Pergjithshem. Ne mungese ajo mund te thirret gjithashtu nga: (a) eksperti kontabel i autorizuar, (b) nga nje mandatmbajtes, i caktuar nga gjyqji, me kerkesen e cdo personi te autorizuar

per nje rast urgjent, ose te nje apo disa aksionereve qe zoterojne se bashku te pakten 1/10 e kapitalit themeltar, (c) nga likujduesi.

Neni 12

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, perveç atyre qe ne baze te ligjit apo ketij statuti duhen marre nga asambleja e jashtezakonshme. Asambleja e zakonshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar.

Neni 13

Mbledhja e Asamblese se Zakonshme

Asambleja e zakonshme merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem ne qofte se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten $\frac{1}{4}$ (njete katerten) e aksioneve me te drejte vote. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet, ne te dyten nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 14

Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme

Vetem asambleja e jashtezakonshme ka kompetenca te ndryshoje statutin me te gjitha dispozitat e tij. Çdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlefshme.

Neni 15

Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten $\frac{1}{2}$ (nje e dyta) e aksioneve dhe ne te dyten $\frac{1}{4}$ (nje e katerta) e aksioneve me te drejte vote. Ne mungese te ketij quorumi mbledhja e dyte e asamblese mund te shtyhet per nje date te mevoneshme, jo me large se dy muaj nga data e thirrjes se pare.

Ajo merr vendim me nje shumice votash prej $\frac{3}{4}$ (tre e katerta) qe u perkasin aksionareve te pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 16

Kryetari dhe Sekretari i Asamblese se Aksionereve

Asambleja e aksionereve drejtohet nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres apo ne mungese te tij nga nje aksioner I zgjedhur nga aksioneret e pranishem ne mbledhje. Ai (Kryetari I Asamblese) asistohet nga nje Sekretar I emeruar nga Asambleja e aksionereve me propozim te Kryetarit te asamblese I cili mban proces – verbalet e asamblese. Proces – verbalet duhen mbajtur ne shqip

dhe greqisht. Proces – verbalet duhen noterizuar nga nje noter I pranishem ne mbledhjen e asamblese.

Neni 17

Thirrja e Asamblese se Aksionereve

Menyra dhe forma e njoftimit te aksionereve dhe e zhvillimit te mbledhjes se asamblese eshte ajo e percaktuar nga legjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare.

Neni 18

Pjesemarrja e aksionereve ne mbledhjen e asamblese

Aksioneret mund te marrin pjese vete ne mbledhjen e asamblese se aksionereve apo te perfaqesohen nga nje perfaqesues me prokure. Prokura e dhene per te perfaqeuar nje aksioner ne mbledhjen e asamblese eshte e vlefshme vetem per nje mbledhje. Prokura mund te jete per dy mbledhje, nga te cilat njera e zakoshme dhe tjetra e jashtezakonshme, qe mbahen ne te njejten dite ose brenda 7 ditesh.

Prokura e dhene per nje mbledhje asambleje eshte e vlefshme edhe per mbledhjet e tjetra te asamblese, te cilat thirren ne vazhdim te te njejtit rend dite.

Neni 19

Verifikimi I pjesemarrjes

Eshte detyre e Kryetarit te asamblese te kontrolloje rregullshmerine e pjesemarrjes ne mbledhje te aksionereve apo perfaqesuesve te tyre.

Neni 20

Keshilli Mbikqyres

Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare te cilet emerohen: (a) 2/3 nga Asambleja e zakonshme e Aksionereve dhe 1/3 nga te punesuarit ne shoqeri sipas procedures te caktuar nga ligji.

Keshilli i pare Mbikqyres do te kete kete perberje;

- 1. Z. Kostandinos Tsoukalidis.**
2. Z. Dimitrios Giannikakis.
3. Z. Vasil Qiriazati.

Neni 21

Kohezgjatja e mandatit te Keshillit Mbikqyres

1. Kohezgjatja e mandatit te Keshillit te pare Mbikqyres eshte 3 vjet. Me mbarimin e mandatit 1/3 e anetareve te Keshillit do te zgjidhet nga te punesuarit sipas percaktimeve te nenit 15.



2. Anetaret e Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga asambleja mund te shkarkohen ne cdo moment nga kjo e fundit, ndersa shkarkimi i anetarit te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit ne shoqeri, behet sipas rregullave qe percakton legjislacioni ne fuqi.
3. Prishja e kontrates se punes i jep fund mandatit te anetarit te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga personeli. Rregullat e prishjes se kontrates se punes percaktohen nga legjislacionine fuqi.

Neni 22

Zevendesimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

1. Ne rastin e vendeve bosh qe krijohen nga vdekja apo doreheqja e nje apo disa anetareve te KM, ky keshill mundet, per periudhen midis dy mbledhjeve te asamblese, te beje emerime te perkoheshme.
2. Kur numri i anetareve te Keshillit Mbikqyres ka zbritur nen minimumin ligjor, Drejtori i Pergjithshem duhet te therres urgjentisht mbledhjen e zakoneshme te asamblese per te plotesuar efektivin e Keshillit Mbikqyres.
3. Emerimet e bera nga Keshilli Mbikqyres, ne baze te paragrafit 1 ketij neni, i nenshtrohen ratifikimit ne mbledhjen e radhes te asamblese se zakoneshme. Ne mungese te ratifikimit, shqyrtimet e bera dhe vendimet e marra me pare nga Keshilli Mbikqyres mbeten gjithmon te vlefshme.
4. Anetari i Keshillit Mbikqyres i emeruar ne zevendesim te nje anetari tjetër, perfundon mandatin e paraardhesit.

Neni 23

Kufizimi i mandateve

Anetaret e Keshillit Mbikqyres (me perjashtim te Keshillit te Pare Mbikqyres), te emeruar nga Asambleja , nuk mund te jene nga te punesuarit ne shoqeri.

Asnje anetar i Keshillit Mbikqyres nuk mund te beje pjese ne me shume se 8 (tete) Keshilla Mbikqyres te shoqerive anonime qe kane seli ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 24

Kryetari dhe zevendes Kryetari i Keshillit Mbikqyres

1. Keshilli Mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therrasin mbledhjen e keshillit dhe drejtojne diskutimet. Ata emerohen per te gjithë kohen e mandatit te tyre ne Keshillin Mbikqyres dhe mund te jene te rizgjedhshem.
2. Keshilli Mbikqyres mund te emeroje nje sekretar jashte anetareve te tij dhe i cakton ketij dhe pagën.



3. Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e Keshillit Mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

Neni 25

Vendimet e Keshillit Mbikqyres

1. Keshilli Mbikqyres mblidhet jo me vone se nje here ne tre muaj dhe sa here e kerkon interesi i shoqerise anonime, me thirrjen e kryetarit ose ne mungese tij te zv.kryetarit
2. Kryetari dhe ne mungese te tij zv.kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesembedhjete) diteve, kur Drejtori i Pergjithshem ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te Keshillit Mbikqyres i parasesin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim.
3. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje atehere anetaret kerkues mund te therrasin keshillin duke i percaktuar rendin e dites.
4. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara me leter, telegram, teleks ose telefaks, por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat ne qofte se anetaret e Keshillit Mbikqyres e pranojne ate.
5. Çdo thirrje duhet te tregojë çështjet kryesore te rendit te dites.
6. Mbledhja e Keshillit Mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrje.
7. Keshilli Mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem n.q.s.jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij.
8. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta ajo e kryetarit eshte percaktuese.
9. Keshilli Mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e keshillit te pranishem ne mbledhje.
10. Vendimet e Keshillit Mbikqyres evidentohen ne procesverbalet e hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga Sekretari i Keshillit Mbikqyres.
11. Kopje te ketyre procesverbaleve vertetohen nga kryetari, (ose ne mungese te tij evendes kryetari) dhe sekretari.

Neni 26

Kompetencat e Keshillit Mbikqyres

1. Keshilli Mbikqyres emeron Drejtorin e Pergjithshem te shoqerise.
2. Keshilli Mbikqyres ka te drejte te aprovoje:
 - (a) Percaktimin dhe ndryshimi e programit vjetor si dhe veprimtarine afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.
 - (b) Kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themelor te shoqerise.



- (c) Hapja e veprimtarive ose e njesive te reja (dege, perfaqesi etj brenda dhe jashte territorit te Shqiperise) .
- (d) Shitja apo shkembimi i pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
- (e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.
- (f) Marrja e huave afatmesme, afatgjata deri ne 2.000.000 (dy million) USD.

- 3. Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administimin e shoqerise nga Drejtori i Pergjithshem.
- 4. Keshilli Mbikqyres autorizon Drejtorin e Pergjithshem qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenin 29 te ketij statuti.
- 5. Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i cmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe e gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.

Neni 27

Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres do te caktohet nga Asambleja e Aksionereve dhe mbulohet nga shoqeria.

Shoqeria njeh gjithashtu dhe shpenzimet e bera nga anetare te Keshillit Mbikqyres kur keta te fundit dergohen me sherbim nga vete Keshilli Mbikqyres per probleme te kompanise.

Neni 28

Drejtori i Pergjithshem

- 1. Shoqeria administrohet nga Drejtori i Pergjithshem.
- 2. Drejtori i Pergjithshem ka te drejte qe brenda kompetencave te tij tu jape nje ose disa punonjesve te kompanise, te drejten per te kryer veprime te vecanta apo kategori veprimesh, me te drejten e nendelegimit.
- 3. Drejtori i Pergjithshem eshte person fizik, ne te kundert emerimi i tij eshte i pavlefshem. Ai mund te zgjidhet edhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje antar i Keshillit Mbikqyres emerohet Drejtor i Pergjithshem mandati i tij ne Keshillin Mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet Drejtor i Pergjithshem ne me shume se nje shoqeri.
- 4. Drejtori i Pergjithshem mund te shkarkohen nga Keshilli Mbikqyres per shkaqe te perligjura. Drejtori i Pergjithshem emerohet per nje periudhe kohe prej 6 (gjashte) vjetesh. Drejtori i Pergjithshem mund te riemerohet.



5. Paga e Drejtorit te Pergjithshem caktohet nga Keshilli Mbikqyres ne aktin e emerimit te tij.
6. Drejtori i Pergjithshem ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.
7. Brenda 3 muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar, Drejtori i Pergjithshem duhet ti paraqese Keshillit Mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli para se keto te miratohen nga Asambleja.
8. Drejtori i Pergjithshem lidh kontrate me Keshillin Mbikqyres per detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i shoqerise.
9. Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve, duhet te nenshkruhen nga Drejtori i Pergjithshem ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.

Neni 29

Marveshje qe kerkojne autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres

Marveshjet qe kerkojne autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres jane:

1. Te gjitha marveshjet qe behen ndermjet shoqerise dhe Drejtorit te Pergjithshem apo ndonje anetari te Keshillit Mbikqyres te shoqerise;
2. Marveshjet, me te cilat nje nga personat e siperpermendur lidhet indirekt, apo ne te cilat ai lidhet me shoqerine nepermjet nje personi ndermjets,
3. Marveshjet qe veprojne ndermjet shoqerise dhe nje subjekti tjetër ekonomik te nje lloji te çfardoshem, ne rast se Drejtori i Pergjithshem apo nje nga anataret Keshillit Mbikqyres te shoqerise eshte pronar, ortak "i pakufizuar", administrator apo antar i drejtorise te subjektit tjetër ekonomik.

Neni 30

Ekspertet kontabel te autorizuar

Kontroli i shoqerise ushtrohet nga ksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga Asambleja e Aksionereve dhe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

Ekspertet e pare kontabel te shoqerise do te jene;

1. Z. Kole Gjoni
2. Z. Elton Haxhi

Neni 31

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.



Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar fillon ne diten e regjistrimit te shoqerise ne gjykate dhe mbaron me 31 Dhjetor 2001.

Neni 32

Inventari - Ilogarite vjetore

1. Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise te saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.
2. Ne mbylljen e ushtrimit financiar, Drejtori i Pergjithshem harton inventarin e pasurise ne kete date dhe Ilogarite vjetore per ushtrimin financiar.
3. Drejtori i Pergjithshem pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar

Neni 33

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit

1. Rezultati i veprimtarise percaktohet nga diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve, pas zbritjes se amortizimeve dhe provizioneve.
2. Nga fitimet e ushtrimit, pasi te jene zbritur, kur eshte rasti humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 (pese) % per te krijuar fondet e reserves te domosdoshme. Kur kjo reserve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar nuk behen me heqje nga fitimet e ushtrimit.
3. Ajo (heqja) rifillon, kur per nje arsye te cfaredoshme, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/ 10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar.
4. Perdorimi i fitimit behet me Vendim te Asamblese se aksionereve.

Neni 34

Likujdimi i shoqerise

Likujdimi i shoqerise do te behet sipas menyres dhe formes te percaktuar me ligj.

Neni 35

Dispozita te pergjithshme

Per cfare nuk eshte shprehur ne statut, referimi behet tek dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi per shoqerite tregtare.

AKSIONERET

Shoqeria Anonime "INTRACOM KONSTRUKSIONE" sh.a.
E cila perfaqesohet me Prokure nga z.Kostas Thanos

Kostas Thanos

Shoqerise Anonime "INTRACOM" sh.a.
E cila perfaqesohet me prokure nga z.Kostas Thanos

Kostas Thanos

Shoqeria anonime "INTRAMET" sh.a.
E cila perfaqesohen me prokure nga z.Kostas Thanos

Kostas Thanos

KOSTAS THANOS

Kostas Thanos